

**KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES
PER SIGURIMIN E KAFSHEVE BUJQESORE (Sigurimi i Blegtorise)**

Dispozita te Pergjithshme

1. Kushtet e pergjithshme te Kontrates per Sigurimin e Kafsheve, me poshte do te quhen "Kushtet e Sigurimit"

1.1. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.A., me poshte do te quhet "Siguruesi"

1.2. Personi fizik ose juridik, i cili ka interes pasuror ose detyrimi per t'u siguruar i buron nga nje kontrate juridiko-civile, qe do te mbulohet me ane te kontrates se sigurimit te kafsheve, me poshte do te quhet "I Siguruari"

1.3. Personi fizik ose juridik, qe ka interes pasuror mbi objektin e siguruar dhe ne dobi te te cilit lidhet kontrata, këtu më poshtë do të quhet "Përfituesi".

Objekti i Sigurimit

2. Siguruesi, nepermjet ketyre kushteve te sigurimit, ofron mbulimin ne sigurim per kafshet si me poshte:

1. Vica me moshe	Deri 2 vjec
2. Meshqerra e mezeter me moshe	2 - 3 vjec
3. Qe' pune me moshe	3 – 10 vjec
4. Lope me moshe	3 – 10 vjec
5. Rrureza dhe milore me moshe	Deri 2 vjec
6. Ftuja dhe ftujake me moshe	Deri 2 vjec
7. Dhen e dhi me moshe	2 – 5 vjec
8. Meza me moshe	1 – 2 vjec
9. Kuaj dhe pela me moshe	3 – 12 vjec
10. Mushka me moshe	3 – 12 vjec
11. Gomere me moshe	3 – 12 vjec
12. Gica me moshe	Deri 2 vjec
13. Dosa dhe harca me moshe	2 – 6 vjec
14. Qen dhe kafshe te tjera shtepiake	
15. Zogj dhe zoga	Deri 6 Muajsh
16. Pula dhe shpende te tjera	05-2 vjec

Rreziqet e Sigurimit

3. Siguruesi mbulon rastet e:

3.1. Ngordhjeve te kafsheve te ndodhura gjate periudhes se sigurimit, per shkak te:

a- Semundjeve te zakonshme.

b- Aksidenteve. Aksident quhet cdo ngjarje e papritur dhe e paparashikuar qe ndodh per shkaqe rastesore, te dhunshme dhe te jashtme te cilat shkaktojne ngordhjen apo therjen e detyruar te kafshes.

- c- Nderhyrjeve kirurgjikale te pesuara per shkak te nje aksidenti apo semundje gjate periudhes se sigurimit. Nderhyrje kirurgjikale, per rastet qe nuk jane akute, behet pasi te jete njoftuar Siguruesi.
- d- Helmimeve aksidentale qe vijne nga ushqimi ose uji.

3.2. Therjeve te detyruara te tyre ne rastet e meposhtme:

- a- Kur urdherohet nga sherbimi veterinar ose nga nje organ tjeter kompetent, ne rastet dhe menyren e parashikuar ne Ligjin nr 10465 date 29.09.2011 " Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise" dhe/ose ne dispozita te tjera ligjore.
- b- Kur kafsha e siguruar peson nje aksident ose semundje te tilla qe do te shkaktoje ne menyre te pashmangshme ngordhjen e saj. Therja e detyruar per rastet qe nuk jane akute behet vetem pasi te jete njoftuar Siguruesi dhe te jete marre miratimi paraprak i tij.

Rreziqet shtese te sigurimit

- 4. Siguruesi mbalon edhe rreziqet shtese te sigurimit si me poshte:

- 4.1** Demtimet nga kafshet grabitqare. Mbulon demtimin e kafsheve ne vendstrehim dhe ne kullote nga ujku, cakalli, ariu, dhelpa (pula dhe shpende te tjere).
- 4.2** Kafshe dhe shpende ne transport. Ky rrezik sigurohet vetem kur transporti behet me mjete te posacme te autorizuara per nje transport te tille.
- 4.3** Demtime nga zjarri ne vend strehim.

Sigurimi i kafsheve eshte i vlefshem vetem per periudhen gjate qendrimit te tyre ne vendet e treguara ne polisen e sigurimit ose edhe ne nje vend tjeter, me kusht qe te jene plotesuar kerkesat e pikes 2 te nenit 19 te ketyre Kushteve te Sigurimit.

Rreziqe te Perjashtuara

- 5. Siguruesi nuk mbalon ne sigurim rreziqet e sigurimit si me poshte:

- a-** Ngordhje qe shkaktohen ne panaire, tregje, konkurime, ekspozime, gara
- b-** Therjet pervec kur parashikohet ne nenin 3 pika 2
- c-** Veprimet e kryera me dashje ose ne formen e pakujdesise se rende te te Siguruarit dhe/ose pjesetareve te familjes si dhe personave te tjera te autorizuar prej tij
- d-** Ngordhje qe shkaktohen ose qe vijne drejtperdrejte apo terthorazi per shkak te:
 - d.1-** Semundjeve ose te metave fizike qe ekzistonin perpara fillimit te periudhes se sigurimit
 - d.2-** Aftes, tuberkulozit, brucelozes, leukozes, mykotoksikozes, ekinokokozes, gelbazes, si dhe te gjitha semundjeve te tjera infektive te parashikuara ne Ligjin nr 10465 date 29.09.2011 " Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise" dhe/ose ne dispozita te tjera ligjore.
 - d.3-** Transportit te kryer me mjete te paautorizuara.
- d.4-** Veprimeve luftarake, pavaresisht ne se eshte shpallur apo jo lufte, grevave, akteve te terrorizmit dhe/ose kryerjes se veprave te tjera penale, permbytjeve, ndotjeve te ambientit, pervec kur i Siguruarit do te provoje se ngjarja nuk konsiderohet si nje nga rreziqet e perjashtuara me siper ne kete paragraph
- d.5-** Pasojave te drejtperdrejta ose jo te rreziqeve berthamore.
- e-** Moszbatin min e kushteve zooveterinare

f- Ngjarje te tilla aksidentale si:

f.1- Shtypja nga mjete motorrike te cdo lloji dhe nga treni

f.2- Gellitija e plehrave dhe lendeve kimike helmuese si ure', superfosfat, plumb etj, trupave te huaj si tela, gozhde etj ne ushqim.

Shuma e Sigruar

6. Shuma e sigruar percaktohet ne polisen e sigurimit ne marreveshje me Siguruesit dhe te Siguruarit. Llogaritja e shumes se sigruar behet duke shumezuar numrin e krereve te kafsheve te sigruara me shumen e sigurimit per cdo koke. Kafshet sigurohen per cdo koke sipas normave te miratuara dhe deklaruara ne skedul, pytesor si dhe dokumentacionin bashkengjitur Kushteve te Sigurimit.

Tarifa

7. Tarifat e primit te sigurimit jane fikse dhe te percaktuara per koke sipas Aneksit nr. 1 bashkengjitur Kushteve te Sigurimit.

Primi i Sigurimit

8. Primi i sigurimit llogaritet duke shumezuar tarifen e sigurimit me shumen e sigruar te rene dakord midis Siguruesit dhe te Siguruarit. Primi i sigurimit paguhet teresist ose me 2 keste te barabarta.

Primi ose kesti i pare i tij paguhet perpara ose ne kohen e dorezimit te polices se sigurimit nga Siguruesi.

Ne rastin e pagimit te primit te sigurimit me 2 keste, kesti i 2 paguhet jo me vone se 60 dite nga data e pagimit te kestit te 1.

Kur kesti i dyte nuk paguhetbrenda 15 diteve pas afatit te mesiperme atehere:

-) Siguruesi ka te drejte te zgjidhe kontraten e sigurimit

-) Humbjet dhe demtimet e vertetuara pas afatit 15 ditor, nuk demshperblehen.

Kur demi ndodh para se te paguhet kesti 2 i primit, shuma e demshperblimit jepet e plete, por zbritet kesti 2 i primit i papaguar.

Kontrata e Sigurimit

9. Kontrata e sigurimit lidhet ne cdo kohe te vitit, per nje periudhe prej 1 vit, per kafshet te cilat permbushin kerkesat e nenit 2 te ketyre Kushteve te Sigurimit.

Kontrata e sigurimit te kafsheve mund te lidhet edhe per dhenien e kredise. Ne kete rast perjegjesia e mbulimit te sigurimit fillon nga momenti i blerjes.

Siguruesi ose i Siguruari kane te drejte te heqin dore deri ne momentin e fillimit te mbulimit ne sigurim, duke bere njoftim me shkrim. Polica e sigurimit do quhet e zgjidhur ne momentin e marrjes se njoftimit me shkrim. I Siguruari ka te drejten e kerkimit te primit ose te kestit te 1 te primit te paguar.

Kontrata e sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24:00 te dites se perfundimit te kontrates dhe mbaron ne oren 24:00 te dites se fundit te kohezgjatjes se kontrates. Kontrata e sigurimit konsiderohet e lidhur kur polica e sigurimit i dorezohet te Siguruarit kundrejt arketimit te primit teresist ose pjeserisht.

Kur kontrata e sigurimit perseritet pa nderprerje, perjegjesia e sigurimit fillon menjehere pas mbarimit te afatit te kontrates se perparshme te sigurimit.

Polica e Sigurimit

10. Polica e sigurimit leshohet mbi bazen e kerkeses me shkrim te te Siguruarit, te cilat se bashku me cdo deklarim e njoftim me shkrim, jane pjese perberese te Kontrates se Sigurimit.

Siguruesi leshon Policen e sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te njoftimeve dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari. Siguruesi ka te drejte te verifikoje vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te te Siguruarit.

I Siguruari mban pergjegjesi per saktesine dhe vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te tij.

Deklarimet e cdo forme te veterinerit te te Siguruarit do konsiderohen si deklarime te te Siguruarit.

11. Polica e sigurimit leshohet per sigurimin e te gjitha kafsheve te te njejtit lloj te cilat permbushin kerkesat e nenit 2 te ketyre Kushteve te Sigurimit.

12. Ne rastet e mbulimit ne sigurim te kafsheve qe jane ne pronesi te personave te ndryshem, ne marreveshje mes tyre dhe Siguruesit mund te perpilohet nje Police e vetme sigurimi, e cila i dorezohet perfaqesuesit te caktuar nga keta pronare.

Cdo pronar do te quhet i Siguruari perkatesisht per ato kafshe te tij qe mbulohen nga koj Ploice Sigurimi.

Periudha e Sigurimit

13. Periudha e mbulimit ne sigurim te kafshes fillon:

1. ne oren 24:00 te dites se pagimit te primit te sigurimit per rastet e ngordhjes dhe/ose therjes se detyruar nga aksidentet

2. pas 21 diteve kalendarike nga data e pagimit te primit te sigurimit per rastet e ngordhjes dhe/ose therjes se detyruar nga semundjet.

Mbikqyrja e Siguruesit

14. Siguruesi ka te drejte te ushtroje kontroll mbi kafshet e siguruara, duke kryer dhe/ose urdheruar kryerjen e verifikimeve ose vizitave mjekesore me shpenzimet e tij.

I Siguruari nuk ka te drejte te pengoje Siguruesin ne ushtrimin e te drejtes se siperpermendur. Ne rast pengimi, Siguruesi ka te drejte te kerkoste zgjidhjen e Kontrates se Sigurimit.

15. Kafshet e siguruara mund te individualizohen ne menyrat e me poshtme:

15.1- Gjedhet -> me matrikullim

15.2- Njethundrake -> me damkosje

15.3- Te imtat dhe derrat ->, me ngjyrosje ose shenja ne vesh

Kur mungojne mundesite e individualizimit te tyre me metodat e mesiperme behet sigurimi duke marre parasysh shenja dalluese te vecanta si ngjyra etj.

Siguruesi, kur e shikon te nevojshme, ka te drejte te kerkoste nje individualizim tjeter te kafsheve te siguruara.

I Siguruari eshte i detyruar te kryeje veprimet e mesiperme.

Shtimi i Rezikut

Detyrimet e te Siguruarit

16. I Siguruari eshte i detyruar:

1- te njoftoje Siguruesin per cdo shtim rreziku; ne keto raste Siguruesi ka te drejte te kerkonte pagimin e nje primi te sigurimit shtese ne menyre proporcionale ose zgjidhjen e Kontrates se Sigurimit.

Ne rast se ngjarja e sigurimit vertetohet perpara njoftimit te shtimit te rrezikut dhe/ose ndryshimit te Polices se Sigurimit, Siguruesi ka te drejte te refuzoje demshperblimin e lidhur me kete ngjarje sigurimi, ose te ofroje nje demshperblim me te vogel ne perpjektim te drejte me ndikimin qe do kishte ky shtim reziku ne pagimin e mundshem te nje primi sigurimi shtese.

2- te njoftoje paraprakisht me shkrim Siguruesin, kur kerkon te transferoje te gjitha ose nje pjese te kafsheve te siguruara ne nje vend te ndryshem nga ai i tregtuar ne polisen e sigurimit. Pelqimi perkates quhet i dhene ne heshtje ne rast se brenda 5 diteve nga marrja e njoftimit te mesiperme Siguruesi nuk vendos ndryshe.

3- te njoftoje menjehere Siguruesin ne rast shitje ose leshimi te te drejtave te tij mbi kafshet e siguruara. Ne kete rast Kontrata e Sigurimit do te mbete ne fuqi per pjesen tjeter te kafsheve te siguruara te tregtuara ne polisen e sigurimit. Kur kafsha e siguruar kalon ne pronesine e nje personi tjeter, kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Ne kete rast primi i paguar i kthehet te siguruarit ne perpjektim me kohen qe mbetet gjer ne mbarimin e afatit te kontrates se sigurimit.

4- te njoftoje menjeher Siguruesin ne rast shtimi te numrit te kafsheve te siguruara. Siguruesi ka te drejten e pranimit ne sigurim te ketyre kafsheve te tjera. Ne rastin e pranimit ne sigurim, Siguruesi do t'i leshoje te Siguruarit nje shtese te polices se sigurimit. Kafshet e siguruar rishtas mbulohen ne sigurim deri ne perfundim te periudhes se sigurimit te treguar ne polisen e sigurimit.

Njoftime dhe deklarime te pasakta

17. Ne rast se njoftimet dhe deklarimet e treguara ne polisen e sigurimit, apo te derguara gjate periudhes se sigurimit, nuk perputhen me gjendjen reale, Siguruesi ka te drejte te kerkonte rillogaritjen e primit te sigurimit ose zgjidhjen e Kontrates se Sigurimit.

Ne rastin e zgjidhjes se Kontrates se Sigurimit, primi i sigurimit nuk i kthehet te Siguruarit, kurse demshperblimet e paguara nga Siguruesi gjate periudhes se mbulimit ne sigurim rikthehen detyrimisht nga I Siguruari.

Ngjarja e Sigurimit

Njoftimet dhe ekspertimi

18.1 Ne rast ngordhje dhe/ose therje e detyruar te nje ose me shume kafsheve te siguruara, I Siguruari eshte i detyruar:

a- te njoftoje brenda 24 oreve me shkrim Siguruesin ne adresen e treguar ne polisen e sigurimit,

b- te kerkonte brenda 24 oreve kryerjen e veprimeve per vertetimin e ngordhjes nga nje veteriner

c- t'i dergoje Siguruesit ne adresen e treguar ne polisen e sigurimit kopjen e raportit te perpiluar nga veterineri qe verteton shkakun dhe rr Ethanat e ngordhjes duke mbajtur sipas rastit lekuren ose shenjat e kafshes se demtuar ne dispozicion te Siguruesit, i cili eshte pronar, pervec kur me akte te organeve kompetente veterinare e sanitare eshte vendosur ndryshe.

d- te marre masat per kryerjen e autopsise nga autoritetet kompetente sanitare apo veterinare dhe te analizave te ndryshme laboratorike ne rast dyshimi per semundje infektive.

18.2 Ne rast aksidenti ose semundje qe peson nje apo disa nga kafshet e siguruara, I Siguruari eshte i detyruar:

a-t'ia nenshtroje menjehere dhe me shpenzimet e veta kafshet e siguruara, vizites se veterinerit, i cili perpilon nje raport te hollesishem.

Ne raste te renda i Siguruari duhet te njoftoje Siguruesin telegrafisht ose ne cdo menyre tjeter me shkrim, brenda 24 oreve nga ngjarja

b- te lejoje dhe te beje te mundur verifikimet e Siguruesit duke permbushur te gjitha kerkesat e tyre te mundshme me shkrim.

18.3 Ne rast semundje infektive qofte edhe vetem per dyshime te semundjeve te tilla, I Siguruari eshte i detyruar:

a- te njoftoje menjehere Siguruesin, i cili ruan te drejten e dergimit dhe nderhyrjes me specialiste te tij.

b- te njoftoje menjehere veterinerin e tij si dhe te zbatoje me rreptesi te gjitha dispozitat e ligjit nr 10465 date 29.09.2011 " Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise"

Te gjitha shpenzimet mjekesore dhe ilacet jane ne ngarkim te te Siguruarit.

Mosbatimi qofte edhe i nje prej detyrimeve te parashikuara ne kete nen, sjell humbjen e se drejtes per demshperblim.

Kerkesa per Demshperblim

19. Siguruesi paguan demshperblimin pas paraqitjes se ketyre dokumenteve:

1- Kerkese me shkrim per kerkimin e demshperblimit nga i Siguruari. Kjo kerkese duhet te paraqitet jo me vone se 30 dite nga ajo e ndodhjes se rastit te sigurimit.

2- njoftimi per ndodhjen e demit

3- raport i perpiluar nga veterineri apo organi kompetent

4- procesverbal i mbajtur nga i Siguruari, veterineri, nje antar i Keshillit ose komunes per sasine e mishit te therur te ngrenshem

Llogaritia e Demshperblimit

20.Kur kafsha e siguuar ngordh ose theret detyrimisht dhe mishi i saj eshte krejtesisht i paperdorshem per ushqimin e njerezve, te Siguruarit i paguhet shuma e siguuar e shenuar ne polisen e sigurimit.

Kur kafsha e siguuar theret detyrimisht dhe mishi i saj eshte teresisht ose pjeserisht i perdorshem per ushqimin e njerezve, te Siguruarit i paguhet diferenca midis shumes se siguuar te kafshes dhe shumes se arketuar nga shitja e mishit ose konsumimi vetjak i tij i vleresuar sipas cmimit te shitjes ne treg.

20. Siguruesi do te demshperbleje te siguuarin pavaresisht nga numri i rasteve te sigurimit, deri ne shumen e siguuar te treguar ne polisen e sigurimit.

Pjesa e Zbritshme

21. Pjesa e zbritshme eshte 10-20% e vleres se demshperblimit per t'u paguar ne cdo rast sigurimi te vertetuar sipas rasteve te siguura.

Pagesa e Demshperblimit

22. Siguruesi ben pagesen e demshperblimit ose e refuzon me shkrim brenda 30 diteve nga ajo e marjes se kerkeses per demshperblim.

23. I Siguruari nuk ka te drejte te kerkoste demshperblimin nga Siguruesi, teresisht apo pjeserisht, ne rast se perfiton demshperblim ne zbatim te ligjit 10465 date 29.09.2011 " Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise" ose sipas dispozitave te tjera ligjore e nenligjore.

Dispozita te tjera

24. Per mosmarreveshet qe lindin mes paleve, kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim, zgjidhen nepermjet Gjykates qe i perket vendit ku eshte leshuar polica e sigurimit.

25. Pervec se eshte parashikuar shprehimisht ne dispozitat e ketyre Kushteve te Sigurimit, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil apo akteve ligjore e nenligjore qe lidhen me sigurimet.